

Lushnje më 09. 03 .2021.

KALLZIM PENAL

Kallzues : Subjekti Partia Demokratike , Dega Lushnje .

Kundër : 1- Shtetasit [REDACTED] i biri [REDACTED] , datëlindja [REDACTED] me detyrë [REDACTED]

Baza ligjore : Neni 280,283 i K.Pr.Penale.

Përpara : PROKURORISË PRANË RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE .

Unë kallzuesi Subjekti Politik "Partia Demokratike", Dega Lushnje, kam rënë në dijeni të një veprimtarie penale të parashikuar nga nenet 248, 328 dhe 328/a të Kodit Penal konkretisht "Shpërdorimi i detyrës", "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" dhe "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore".

Shtetasi [REDACTED] me detyrë [REDACTED] u ka kërkuar punonjësve të këtij institucioni mbledhjen e kartave të identitetit të çdo punonjësi, duke i detyruar të angazhohen në veprimtari të politike dhe elektorale të subjektit politik "Partia Socialiste". këtyre punonjësve u është lënë detyrë marrja e kartave të personave pjesë të familjes së tyre si dhe çdo personi tjetër që mund apo detyrohet prej tyre për të votuar këtë subjekt politik.

Shtetasi [REDACTED] ka zhvilluar fushatë dhe ka premtuar punësim [REDACTED] në këmbim të premtimit prej tyre për të votuar Partinë Socialiste. Ndërkohë procedura për ata persona që nuk janë të angazhuar politikisht ka qenë mëse e gjatë.

Shtetasi [REDACTED] ka kërcënuar punonjësit e tij se në rast të mos angazhimit të tyre në Partinë Socialiste apo në fushatë si dhe mos votimit të këtij subjekti, ndaj tyre do të merren masa administrative deri në largimin nga detyra.

Kjo veprimtari e shtetasit [REDACTED] është duke u zhvilluar dhe nuk ka përfunduar, me synim vazhdimin e saj deri më 25.04.2021. [REDACTED] disponon numrin e telefonit personal [REDACTED]

Ne shprehim besimin se institucioni juaj do të veprojë në mënyrë të shpejtë, efikase dhe pa ngurrim. Presim me vëmendje maksimale dhënien rrugë të këtij kallzimi sipas procedurës përkatëse.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin !

KALLZUESI